

Master i Shkencave në **Informatikë Biznesi** (120 ECTS, 2 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Cikli i dytë i studimit Master i Shkencave “Informatikë Biznesi” është vazhdim i ciklit të parë të studimeve Bachelor “Informatikë Biznesi”, i cili synon përgatitjen e specialistëve të rinj të aftë për shfrytëzimin efektiv të informacionit, teknologjisë dhe inovacionit në funksion të biznesit.

Ky master synon të zhvillojë aftësitë në vënien në funksion të teknologjisë dhe inovacionit në zgjidhjen e problemeve dhe menaxhimin e biznesit. Studentët do të gjejnë një program mjaft tërheqës multidisiplinar, i cili mikson qasjet programuese për strukturim dhe përpunim të dhënash ekonomike, strategjike dhe manaxheriale në mënyrë që të analizojë dhe të drejtojë me kompetencë inovacionin dhe teknologjinë në nivel firme të vogël apo të mesme dhe të arrijë kështu përparësi në treg, në nivel nacional po edhe më gjerë.

Objektivat kryesore formuese të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Informatikë Biznesi” janë:

- të zhvillojme dije dhe njohuri shkencore dhe aplikative për përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit.
- të zhvillojmë aftësitë analitike të kërkuara për të kuptuar nevojën për zhvillimin dhe shfrytëzimin e ndryshimit dinamik të teknologjisë brenda dhe nëpër organizata si një gjenerator i rëndësishëm për tu përshtatur me dinamikën e zhvillimeve globale.
- të zhvilljmë aftësitë për programimin dhe përdorim të aplikacioneve desktop dhe ëeb;
- të zhvillojmë aftësitë vendimmarrëse për kthimin e ideve të reja në produkte materiale ose shërbime dhe përfitime evidentë për bizneset.
- të zhvillojmë aftësitë në zgjidhjen e problemeve duke nxitur inovacionin dhe kërkimin për mundësi të reja në treg.

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

a. Formim i përgjithshëm

1. Kërkim dhe Analizë Tregu
2. Metodologji Kërkimi

b. Formim baze karakterizues

1. Inteligjencë Artificiale
2. Inxhinieri Software
3. Administrim Bazë të dhënash
4. Ekonometri e Avancuar
5. E-commerce në Bujqësi
6. Programim i Avancuar Web
7. IoT
8. Menaxhimi i Projekteve

9. Programim Mobile
10. Hyrje në Kriptografi
11. Data mining
12. Teoria e Vendimmarrjes
13. Data Visualization

c. Formim integrues

1. Drejtim Financiar
2. Drejtim Marketingu
3. Menaxhimi Strategjik
4. Ekonomiksi i Drejtimit
5. Mikroekonomi II
6. Menaxhim Risku Biznesi
7. Siguria në Rrjeta
8. Administrim Linux

Mundësitë për punësim

Në ditët e sotme dinamika e zhvillimit të profesioneve ka qenë e jashtëzakonshme. Kësisoj si rezultat i zhvillimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe shndërrimit të saj në një instrument transformues për bizneset dhe pse jo edhe një avantazh krahasues në një mjedis mjaft kompetitiv, aktorët e tregut po dëshmojnë gjithnjë dhe më tepër një “uri të dukshme” për profesionet e lidhura me përdorimin e teknologjisë. Të diplomuarit tanë do të përgatiten të luajnë role të ndryshme në këtë mjedis si: analist, konsulent biznesi dhe sistemesh informacioni në biznese dhe institucione të ndryshme financiare, menaxher, programues, kërkues tregu, administrator i sistemeve apo rrjeteve nëpër kompani me profile të ndryshme, etj, në projektet inovative, në sistemin e agrobiznesit, në kompani të tjera vendase apo të huaja, në organizata kombëtare apo ato ndërkombëtare, administratë, sektorin bankar, apo të punojnë si kërkues për zhvillimin dhe lançimin e produkteve të reja.

Ky program do të mundësojë gjithashtu zhvillimin e aftësive të të diplomuarve për krijimin e bizneseve të tyre si dhe do t’ju japë atyre mundësinë e ndjekjes më tej të studimeve në nivel të doktoraturës në këtë fushë zhvillimi profesional. Disa kompani ku studentët mund të punësohen janë:

- Administrata publike;
- Sistemi bankar;
- Kompanitë e telefonisë celulare;
- Kompanitë e mediave televizive dhe ato radio;
- Biznese private etj.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite	
Viti I, Semestri I (1)	1	Kërkim dhe Analizë e Tregu	5	
	2	Inteligjencë Artificiale	5	
	3	Metodologji Kërkimi	5	
	4	Inxhinieri Software	5	
	5	Administrim Bazë të Dhënash	5	
	<i>Module me Zgjedhje I</i>			
	6	<i>Drejtimit Marketingu</i> <i>Drejtimit Financiar</i>	5	
Viti I, Semestri II (2)	1	Ekonometri e Avancuar	5	
	2	E-commerce në Bujqësi	5	
	3	Programim i Avanc. Web	5	
	4	IoT	5	
	5	Menaxhimi i Projekteve	5	
	<i>Module me Zgjedhje II</i>			
	6	<i>Menaxhimi Strategjik</i> <i>Ekonomiksi i Drejtimit</i>	5 5	
Viti II, Semestri I (3)	1	Hyrje në Kriptografi	5	
	2	Data Mining	5	
	3	Sistemet e Info. Kontabël	5	
	4	Programim Mobile	5	
	5	Teoria e Vendimmarrjes	5	
	<i>Module me Zgjedhje III</i>			
	6	<i>Mikroekonomi II</i> <i>Menaxhim Rrisku Biznesi</i>	5 5	
Viti II, Semestri II (4)	1	Data Visualization	5	
	<i>Module me Zgjedhje IV</i>			
	2	<i>Siguria në Rrjeta</i> <i>Administim Linux</i>	5 5	
	3	Praktikë Profesionale	7	
	4	Temë Diplome	13	
Totali i Krediteve		1+2+3+4	120	